



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-059

Prishtinë, më 1 mars 2019, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 1 MARS 2019

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Aida Dërguti dhe Mufera Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Lirije Kajtazi, Elmi Reçica, Shqipe Pantina, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyqi dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Kërkesa e 44 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme, më 5 mars 2019,
2. Kërkesa e 44 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme, më 6 mars 2019,
3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Kërkesa e 44 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme, më 5 mars 2019,

2. Kërkesa e 44 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme, më 6 mars 2019

Kryetari i njoftoi të pranishmit se 44 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kanë kërkuar mbajtjen e dy (2) seancave të jashtëzakonshme të Kuvendit, më 5 dhe 6 mars 2019, në orën 10:00, për mbajtjen e debateve parlamentare lidhur me vendimet e Qeverisë për ndarjen e mjeteve financiare nga shpenzimet e paparashikuara dhe në lidhje me bllokimin e Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve nga Presidenti.

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me kërkesat e lartshënuara, vendosi që Kuvendi t'i mbajë dy seanca të jashtëzakonshme, si në vijim:

I. Seanca e jashtëzakonshme do të mbahet të martën, më 5 mars 2019, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Debat parlamentar lidhur me vendimet e Qeverisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare nga shpenzimet e paparashikuara

II. Seanca e jashtëzakonshme do të mbahet të mërkurën, më 6 mars 2019, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Debat parlamentar në lidhje me bllokimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga Presidenti

3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari i njoftoi të pranishmit me pikat e rendit të ditës që i plotësojnë kushtet formale për shqyrtim në seancë plenare, si dhe propozoi që seanca plenare të mbahet të enjten, më 7 mars 2019, në orën 10:00.

Në lidhje me përgatitjet për seancën plenare të radhës diskutuan: Shqipe Pantina, në emër të GP të PSD-së, dhe Bilall Sherifi, kryetar i GP-të Nismës Socialdemokrate, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Me propozim të deputetes Shqipe Pantina, në emër të GP të PSD-së, Kryesia e shtyu për një seancë tjetër interpelancën e ministrit të Punës, zotit Skender Reçica, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, mbështetur edhe nga 11 deputetë nga Grupi Parlamentar i PSD-së në lidhje me vdekjet dhe lëndimet e punëtorëve në vendin e punës.

Në vazhdim, kryetari propozoi që edhe disa pika të tjera të ë cilat janë të propozuara për rend të ditës për seancën plenare të radhës të shtyhen për një seancë tjetër. Diskutimi i kryetarit Veseli është dhënë në transkript.

Me propozim të nënkryetares së Kuvendit, znj. Aida Dërguti, Kryesia e shtyu për një seancë tjetër - Shqyrtimin e propozim-amendamentit numër 26 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuar nga 80 deputetë të Kuvendit.

Gjithashtu, kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli, i njoftoi të pranishmit se seancës plenare të radhës do t'i propozohet për miratim një rezolutë në lidhje me rastin e vëllezërve Bytyçi.

Kryesia, pasi diskutoi, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet të enjten, më 7 mars 2019, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
- 4. Miratimi i rezolutës në lidhje me vëllezërit Bytyqi,*
- 5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,*
- 6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/22 për Kinematografinë,*
- 7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta,*

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-097 për bibliotekat,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësim ndryshim të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit,
11. Shqyrtimi i parë i Projekt-Kodit të Procedurës Penale,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Diasporën,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit të punës,
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pronën publike,
17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pijet e forta alkoolike,
18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/l-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/l-247,
19. Interpelanca e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, në lidhje me mosçaktivimin dhe rritjen e pagës minimale në Republikën e Kosovës,
20. Interpelanca e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, z. Valdrin Lluka, sipas kërkesës së kryetarit të GP Partia Socialdemokrate, z. Dardan Sejdiu, i mbështetur edhe nga 11 deputetë, në lidhje me themelimin e Ndërmarrjes së Re Energjetike të Kosovës Sh. ANKEC.

* * *

Më pas, kryetari i njoftoi të pranishmit se Kuvendi do ta mbajë edhe një seancë të veçantë, më 6 mars 2019, në orën 15:30, për shënimin e 21-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por ai tha se në lidhje me këtë çështje ende nuk e kemi pranuar kërkesën nga Qeveria.

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. Nisma Legjislative “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256

Kryesia, pasi e shqyrtoi nismën legjislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legislative “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256”, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

2. Kërkesa e deputetit Xhelal Sveçla për kompensimin lidhur me ushtrimin e detyrës si kryesues i Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Zëvendëskryetarit të parë të Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, z. Xhela Sveçla, i cili në mungesë të kryetarit të komisionit, i ka udhëhequr mbledhjet e këtij komisioni, nuk i takon kompensim shtesë, ngase i njëjti kompensohet sipas vendimit nr.04-V-079, datë: 10 tetor 2011.

3. Kërkesa e deputetes Flora Brovina për lejimin e udhëtimit zyrtar në Vietnam

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Flora Brovina, në Vietnam, prej 24 shkurt deri më 2 mars 2019.

4. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Mal të Zi

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Blerta Deliu-Kodra dhe Fidan Rekalii u lejohet udhëtimi zyrtar në Podgoricë (Mal të Zi), prej 14 - 17 prill 2019.

5. Kërkesa për aprovimin e pjesëmarrjes në aktivitetet e Asamblesë Parlamentare të Frankonisë në Xhibuti (Republika e Xhibutit)

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Flora Brovina, Sami Kurteshi dhe Haxhi Shala u lejohet udhëtimi zyrtar në Xhibut (Republika e Xhibutit), prej 4 - 8 mars 2019. Ndërkohë, deputetët të lartshënuar të cilëve iu lejua udhëtimi zyrtar janë tërhequr nga realizimi i këtij udhëtimi.

6. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të delegacionit nga Parlamenti Britanik dhe Parlamenti i Kroacisë, të cilët kanë qëndruar në Kosovë, për nderë të 11-të vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit, si dhe shpenzimeve tjera të dala me rastin e pritjes së delegacioneve nga Parlamenti të Mbretërisë së Bashkuar dhe Parlamenti i Kroacisë, në lidhje me vizitën e tyre të realizuar në Kosovë, me rastin e shënimit të 11-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

7. Kërkesa e znj. Lola Shehi-Çela për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Znj. Lola Shehi-Çela, nga Tirana (Shqipëri) mbështetet financiarisht në shumën prej 2,000.00 (dymijë) euro për botimin e librit, me tematikë femrat e dhunuara gjatë luftës në Kosovë.

8. Kërkesa e drejtorit ekzekutiv të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, z. Behxhet Shala, për vazhdimin e mbështetjes financiare

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut mbështetet financiarisht në shumën prej 5,000.00 (pesëmijë) euro për realizimin e aktiviteteve të këtij këshilli.

9. Kërkesa e Shoqatës Kosovare të të Shurdhërve për mbështetje financiare

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Shoqata Kosovare e të Shurdhërve, me seli në Prishtinë, mbështetet financiarisht në shumën prej 2,680.00 euro për pjesëmarrjen e dy (2) përfaqësuesve të kësaj shoqate në Kongresin e Asamblesë së Federatës Botërore të të Shurdhëve dhe në Konferencën e Shoqatës Botërore të Interpretëve të gjuhës së shenjave, të cilat do të mbahen në Paris (Francë), nga 21 - 27 korrik 2019.

10. Kërkesa e Shoqatës së Grave të Prizrenit “ORKIDE” për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Shoqata e Grave të Prizrenit “ORKIDE”, me seli në Prizren, mbështetet financiarisht në shumën prej 3,000.00 (tremijë) euro për projektin “Fuqizimi i grave të Kosovës në fushën e të drejtave të grave dhe punësimi”.

11. Kërkesa e Shoqatës HANDIKOS për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Shoqata HANDIKOS, me seli në Prishtinë, mbështetet financiarisht në shumën prej 3,000.00 (tremijë) euro për projektin “Jetesa e pavarur”, që ka të bëjë me mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, i cili do të implementohet për tre (3) muaj.

12. Kërkesa e Shoqatës Multiethnic Culture of Kosovo për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

OJQ Multiethnic Culture of Kosovo mbështetet financiarisht në shumën prej 2,500.00 (dymijë e pesëqind) euro për projektin e organizimit “Java Kulturore Rome”.

13. Kërkesa e shkrimtarit dhe gazetarit Albert Shala për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Z. Albert Shala, nga Gjakova mbështetet financiarisht në shumën prej 2,000.00 (dymijë) euro për botimin e librit “ Krimet serbe dhe rezistenca shqiptare”.

* * *

Kryesia, pasi i shqyrtoi kërkesat lartshënuara për mbështetje financiare, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Duhet ndaluar procedimin e kërkesave për mbështetje financiare, me përjashtime të rasteve të veçanta, për të cilat, para se të procedohen për shqyrtim në Kryesinë e Kuvendit, duhet të shqyrtohen nga nënkryetarët e Kuvendit, z. Xhavit Haliti dhe z. Kujtim Shala.

14. Kërkesa e deputetes Sala Berisha Shala për lejimin e avancit lidhur me udhëtimin zyrtar në Kanada

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Sala Berisha-Shala, i lejohet avanci në shumën prej 1,300.00 (njëmijë e treqind) euro për realizimin e udhëtimit zyrtar në Toronto (Kanada), prej 2 - 10 mars 2019.

15. Kërkesa e zyrtareve të Administratës së Kuvendit për mbështetje financiare me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Lejohet mbulimi i pjesshëm i shpenzimeve, në shumën prej 45 (katër dhjetë e pesë) euro për çdo zyrtare të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, për realizimin e udhëtimit treditor, nga 8 - 10 mars 2019, në Strugë, Ohër, Pogradec dhe Korçë, me rastin e 8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas.

16. Kërkesa e nënkryetares së Kuvendit, znj. Mufera Shinik, për rekrutimin e një zyrtari në Kuvend për përkthim nga gjuha turke, angleze dhe shqipe

Kryesia e miratoi kërkesën e lartshënuar, e cila është përfshirë në vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Organogramit të Administratës së Kuvendit.

17. Kërkesa për aprovimin e themelimit të Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

I. Themelohet Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm, në këtë përbërje:

1. Kryetari/ja e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, kryesuese,
2. Anëtarët e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale,
3. Kryetarët e komisioneve parlamentare të Kuvendit të Kosovës, siç përcaktohet me Rezolutën nr. 06- R-001 të Kuvendit të Kosovës për miratimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm,
4. Deputët e interesuar për të kontribuar në proceset e OZHQ-ve në Kosovë,
4. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Kosovës dhe
5. Përfaqësuesit e Grupit të Grave Deputete dhe grupeve të tjera joformale.

II. Anëtarë të jashtëm:

1. Përfaqësues nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit të Kosovës,
2. Përfaqësues të Zyrës së Kryeministrit,
3. Përfaqësues nga Institucioni i Presidentit të Kosovës,
4. Agjencia e Statistikave të Kosovës,
5. Përfaqësuesit e anëtarëve të Ekipit të Kombeve të Bashkuara në Kosovës (UNKT) dhe organizatave të tjera ndërkombëtare të interesuara për të kontribuar në arritjen e OZHQ-ve në Kosovë dhe
6. Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës dhe rrjete tjera të shoqërisë civile.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kryesia e Kuvendit.

18. Vlerësimi i projekteve të binjakëzimit të financuara nga BE-ja në mbështetje të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe rekomandimet

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Ismet Krasniqi, e njoftoi Kryesinë e Kuvendit për vlerësimin e projekteve të Binjakëzimit për mbështetje Administratës së Kuvendit, të financuara nga Komisioni Evropian, e të realizuara ndërmjet viteve 2011-2018, si dhe për rekomandimet e dala nga vlerësimi i tyre. Diskutimi i sekretarit të Kuvendit, z. Krasniqi, është i dhënë në transkript.

19. Njoftimi për mbajtjen e Seminarit 101 Rose-Roth të Asamblesë Parlamentare të NATO-s në Republikën e Kosovës, nga 13 - 15 nëntor 2019

Nënkryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Xhavit Haliti, e njoftoi Kryesinë e Kuvendit lidhur me përgatitjet për organizimin e Seminarit 101 Rose-Roth të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, i cili do të mbahet në Prishtinë, nga 13 - 15 nëntor 2019.

Kryesia, në lidhje me mbajtjen e seminarit të lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi i Republikës së Kosovës do t'i mbulojë shpenzimet e parapara për Seminarin 101 Rose-Roth të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, i cili do të mbahet në Prishtinë, nga 13 - 15 nëntor 2019, sipas kërkesës së bashkangjitur me nr. 06/2695/Do-1362, datë 21. 1. 2019.

20. Njoftimi i deputetit Labinot Tahiri për bashkëngjitjen e tij në GP të AAK-së

Kryesia u njoftua me shkrim nga deputeti Labinot Tahiri për bashkëngjitjen e tij në Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, nga data 4 shkurt 2019.

21. Raporti i delegacionit të Kuvendit lidhur me pjesëmarrjen e tij në punimet e Sesionit I të rregullt të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës në Francë, nga 20 - 25 janar 2019

Kryesia u njoftua me shkrim nga delegacioni i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, lidhur me pjesëmarrjen e tyre në Sesionin e parë të rregullt të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, i cili është mbajtur në Francë, nga 20 - 25 janar 2019.

22. Njoftimi i deputetit Avdullah Hoti lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Bruksel

Kryesia u njoftua me shkrim nga deputeti Avdullah Hoti për realizimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel, në muajin shkurt 2019.

23. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit për nëntëmujorin e vitit 2018

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e shpenzimeve të Kuvendit për nëntëmujorin e vitit 2018, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për nëntëmujorin e vitit 2018, sipas pasqyrave të paraqitura nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Administrata e Kuvendit.

24. Kërkesa e Shoqatës Down Sindrom Kosova për mbështetje financiare

Kryesia vendosi që ta mbështesë financiarisht Shoqatën Down Syndrome Kosova në shumën prej 5,000.00 (pesëmijë) euro për realizimin e programit të intervenimit dhe edukimit të hershëm.

25. Kërkesa e Hafiz Mehmetit, qytetar nga veriu i Mitrovicës në Këshillin e Kroit të Vitakut, për mbështetje financiare

Kryesia vendosi që z. Hafiz Mehmeti, nga Mitrovica, ta mbështesë financiarisht në shumën prej 4,500.00 (katërmijë e pesëqind) euro për shkak të fatkeqësisë së ndodhur, djegies së shtëpisë së tij.

26. Propozim për dhurimin e veturës së blinduar të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia, lidhur me propozimin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Vetura “Toyota Land Cruiser 4.5 (VDJ200 - GXR WAGON)” e Kuvendit të Republikës së Kosovës, me numër të regjistrimit 2Z-001-02 (01 841 DO), numër i shasisë JTMHV09J095002489, viti i prodhimit 2009 i dhurohet Policisë së Kosovës.

27. Propozimi për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Ismet Krasniqi, e arsyetoi para anëtarëve të Kryesisë propozimin për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryesia, me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës, mori këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës

I. Rregullorja për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, e miratuar nga Kryesia e Kuvendit, me Vendimin nr. 04-V-396, datë 5 shtator 2013, e plotësuar dhe ndryshuar në vitin 2013 dhe 2016, ndryshohet dhe plotësohet, si në vijim:

1. Në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës shtohet një (1) pozitë të re:

- Zyrtar ligjor, me koeficient 7.

2. Drejtoria për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, shtohen pozitat si në vijim:

- Njësia për Integritet Evropian
 - Koordinator i Njesisë, me koeficient 9 (1 pozitë)
 - Zyrtar i lartë për koordinim, me koeficient 8 (2 pozita).

3. Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun plotësohet si në vijim:

- Zyrtar i Programit për Edukim Qytetar, jo i karrierës, me koeficient 7 (1 pozitë).

4. Drejtoria e Përgjithshme e Administratës

Në Drejtorinë e Shërbimeve Teknike, shtohen pozitat si në vijim:

- Zyrtar për emergjencë, me koeficient 7 (një pozitë)
- Asistent administrativ (receptionist), me koeficient 6 (3 pozita).

Në Drejtorinë për Shërbime Gjuhësore - Njësia për përkthim, shtohet pozita si në vijim:

- Zyrtar për përkthim anglisht-turqisht-anglisht, me koeficient 7 (një (1) pozitë).

5. Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale

Në Drejtorinë për Çështje Plenare dhe Procedurale - Njësia për Transkriptim dhe Lekturë, shtohet numri i kryerësve, si në vijim:

- Operator/daktilograf, me koeficient 6 (5 pozita)
- Pozita nëpunës teknik administrativ një (1) kryerës kalon nga Njësia e Shërbimit të Deputetëve në Njësinë për Propozime dhe Parashtrës.

Në Drejtorinë për Hulumtime, Bibliotekë dhe Arkiv - Njësia për Hulumtime shtohet numri i kryerësve, si në vijim:

- Zyrtar i lartë për hulumtime legislative, me koeficient 8 (3 pozita).

II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Shtojca nr. 1 - Përshkrimin e detyrave të punës.

28. Rregullimi i sallës së seancës plenare

Nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, e shtroi çështjen e kushteve të punës në sallën e seancave plenare: ngrohja, ajrosja, ventilimi dhe ulëset e deputetëve. Ai propozoi që Kryesia e Kuvendit të marrë vendim për fillimin e përgatitjeve të nevojshme për rregullimin e sallës së seancave plenare. Diskutimi i tij i plotë është i dhënë në transkript.

Në lidhje me propozimin e lartshënuar diskutuan kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli, dhe nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia mori këtë:

V E N D I M

Ngarkohet Administrata e Kuvendit që ta fillojë procedurën për Projektin e përmirësimit të kushteve të punës në sallën plenare të Kuvendit: ngrohja, ajrosja dhe rregullimi i ulëseve të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 12:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit:
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*